

(Albansk – Shqip)

Të dashur banorë të Kristiansandit me prejardhje shumkulturore

Ne në komunën tonë kemi pranuar një numër pyetjesh nga ju dhe do ta shfrytzojm mundësin për të shpallur një informacion të përmbledhur.

Siç e dini, jetojmë në një kohë kur duhet të kufizojmë tejet shumë kontaktet tona me njëri-tjetrin. Termi, që unë jam i sigurt se e njihni, është "Distancimi shoqëror"

Kjo është akoma shumë aktuale dhe ne nuk mund të ndalemi ta marrim atë me seriozitet të plotë. Komuna është duke u përpjekur, në këtë kohë, për ti ruajtur sa më shumë të jet e mundur ofertat tona, sikurse disa nga ju do të informoheni se mësimi shkollor tani zhvillohet përmes përdorimit të internetit. Komuna ka shumë punonjës dhe një numër i madh i tyre vazhdojnë të punojnë nga shtëpia. Kjo do të thotë se ka mundësi që ti kontaktoni dhe të merrni përgjigje në pyetjet tuaja. Megjithkëtë, më mirë është ta përdorni telefonin po të keni mundësi.

Ne kemi marrë disa pyetje në lidhje me pajisjet e sigurisë, të tilla si maska dhe lëngje për dezinfikimin e duarve.

Maska: Maska nuk siguron mbrojtje për një kohë gjatë dhe duhet të përdoret vetëm nga personeli shëndetsor.

Dezinfektues për duar: Shumë vështirë mund të gjeni. Pak a shumë është shitur në të gjithë vendin dhe komuna nuk ka kurrfarë mundësie për të kontribuar këtu. Megjithatë, ajo çka është shumë pozitive është se sapuni dhe uji në fakt janë më efikas. Këshilla më e mirë është të laheni shumë dhe shpesh, për të mos thënë edhe hollësisht.

Disa kanë pyetur sa kohë duhet të presim vazhdimin e këtyre masave. Nuk është e mundur të jipet një përgjigje, por atë që u tha nga qeveria dje është se ne duhet të llogarisim me këto masa të rrepta deri pas Pashkëve. Kjo do të thotë, deri më 13 prill 2020. Do të ketë më shumë informacion mbi situatën para kësaj date.

Më 12 mars 2020 Qeveria përjetësoi një sërë masash me shpresë për të ndaluar virusin. Masat janë më të ashpra dhe më radikale që kemi pasur në Norvegji në kohë paqeje. Këto vlejné siç është thënë deri më 13 prill, dhe pikat kryesore janë:

- Çdo njeri duhet të mbajë të paktën një metër distancë nga të tjerët
- Kur ndodhemi jashtë, nuk duhet të jemi më shumë se **pesë persona në të njëjtin grup**.
 - Mos stërvitni së bashku në grupe të mëdha apo të organizoni festa.
- Është e rëndësishme të vazhdoni ti lani duart shpesh dhe hollësisht. Lani duart para se të dilni jashtë, posa të ktheheni në shtëpi dhe para se të hani. Gjithashtu, përpiquini të mos e prekni fytyren tuaj.
- Po qe se jeni ftohur apo keni dhimbje të fytyrës, ju duhet të qëndroni në shtëpi edhe një ditë, pasi të jeni shëruar.

Kujdesuni për njëri-tjetrin

Me përshëndetje të singerta

Kim Henrik Gronert

Këshilltar për dialog multikulturor, komuna e Kristiansandit